



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit: 21.6.7-2018-08**

**RAPORT I AUDITIMIT**

**PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR PËR PROJEKTIN**  
**"PROGRAMI MJEDISOR I KOSOVËS - PMK 2016-2020" PËR VITIN**  
**E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

*Auditim në bazë të marrëveshjes me SIDA*

**Prishtinë, maj 2019**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Raportin Vjetor Financiar për Projektin “Programi mjedisor i Kosovës – PMK 2016-2020”, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Vlora Spanca, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Saranda Husaj Baraliu (udhëheqëse ekipi) dhe Jehona Krasniqi e Ramadan Gashi (anëtarë të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Samir Zymeri.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	9
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	12

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor për projektin “Programi mjedisor i Kosovës – PMK 2016-2020”, për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Raportin Financiar Vjetor.

Objektivi zhvillimor i projektit është forcimi i sistemeve të përzgjedhura që kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë, llogaridhënies, dhe efikasitetit të Mjedisit në Republikën e Kosovës. Projekti synon të kontribuoj në përmirësimin e kushteve mjedisore në Kosovë. Objektivat e projektit janë:

- zhvillimi i kapaciteteve të MMPH, Këshillimit Ndërmjësor për Ujëra, komunave, shoqërisë civile dhe palëve tjera të interesit që janë në monitorim dhe menaxhim të mjedisit;
- zhvillimi i kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit mjedisor, në përputhje me direktivat e BE-së;
- rritja e njohurive mbi burimet ujore të Kosovës dhe zhvillimi i kapaciteteve për menaxhimin e zonave të mbrojtura ndërkufitare.

MMPH në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat e marrëveshjes së veçantë ndërmjet Qeverisë së Kosovës<sup>1</sup>, dhe Suedisë<sup>2</sup>, për fondet e shpenzuara nga MMPH-ja duhet të përgatit raportin përmbledhës dhe raportimin financiar në përputhje me marrëveshjen përkatëse.

Ekzaminimi i raportit financiar për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me raportin financiar. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, për vitin 2018.

Auditimi është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin e vitit 2018 është përcaktuar varësisht nga shpenzimet e ndodhura për këtë periudhë.

<sup>1</sup> Përfaqësuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

<sup>2</sup> Përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, SIDA (Suedia)

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Raporti Financiar Vjetor për vitin 2018 *paraqet një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Theksim i çështjes

Në raportin financiar të PMK-së, figurojnë shpenzimet në vlerë prej 57,297€, ndërsa në të dhënat e Thesarit kjo shumë nuk figuron për vitin 2018, pasi që pagesa është kryer në mars të vitit 2019.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

---

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) në bazë të marrëveshjes/kontratës me Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e raportit financiar dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat/raporti financiar japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Kërkesat e marrëveshjes së veçantë ndërmjet Qeverisë së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Suedisë, përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, SIDA (Suedia);
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

MMPH raporton në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat e marrëveshjes së veçantë ndërmjet Qeverisë së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Suedisë, përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, SIDA (Suedia). Raportimi financiar, në lidhje me fondet e shpenzuara MMPH-ja duhet t'i ofroj Suedisë raporte financiare tremujore dhe me raport financiar vjetor sipas afateve të përcaktuara.

Metodologjia e auditimit është fokusuar në ekzaminimin e të dhënave dhe transaksioneve financiare, përfshirë dokumentacionin mbështetës. Ne kemi përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit.

Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Në raport do të vendosen gjetjet që janë pjese e opinionit për pasqyra financiare. Ndërsa për çështjet tjera që kanë të bëjnë me aspektin e menaxhimit financiar, funksionimin e kontrollit të brendshëm dhe çështjet e pajtueshmërisë do të paraqiten në letër për menaxhment.

---

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi ynë i raportit financiar vjetor merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në raportin financiar. Po ashtu ne kemi konsideruar edhe krahasimin e realizimit të shpenzimeve në raport me planifikimin e aktiviteteve të projektit.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar Raportin Financiar Vjetor të projektit të financuar nga SIDA "Programi mjedisor i Kosovës – PMK 2016-2020", për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 i cili përfshinë shpenzimet, një përmbledhje të krahasimit të buxhetit me shumat aktuale dhe shënimet shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, Raporti Financiar Vjetor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezanton një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat për raportim në marrëveshjen në mes të palëve, duke respektuar parimet e kontabilitetit.

#### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

#### Theksim i çështjes

Në linjën prokurimi i shërbimeve, në raportin e PMK, janë prezantuar shpenzimet e ndodhura në tremujorin e fundit të vitit 2018, për shërbimet e realizuara nga Operatori për Shërbime Kontraktuese (OSHK) në vlerë prej 57,297€, ndërsa në të dhënat e Thesarit kjo shumë nuk figuron për vitin 2018. Pasi që pagesa është kryer në mars të vitit 2019 dhe dallimit në bazën e mbajtjes së shënimeve/kontabilitetit të projektit.

Opinioni ynë nuk është i modifikuar në lidhje me çështjen e theksuar.

#### Baza për kontabilitet

Në dëshirojmë të tërheqim vëmendjen lidhur me raportin financiar, i cili është përgatitur sipas marrëveshjes/kërkesës ndërmjet palëve përfshirë bazen e kontabilitetit, e cila nuk harmonizohet plotësisht me sistemin vendor/Qeverisë. Si rezultat i kësaj raporti financiar mund të mos jetë i përshtatshëm për ndonjë qëllim tjetër.

### **Çështjet kyçe të auditimit**

Përveç çështjeve të përshkruara në bazën për opinion, konkludojmë se nuk ka çështje kyçe të auditimit për t'u komunikuar.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV/RFV**

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) është përgjegjëse për zbatimin e projektit dhe për menaxhimin e mjeteve financiare nga SIDA. Kontributi financiar i SIDA-së përbëhet nga dy pjesë: disbursimet drejtpërdrejt tek Qeveria (Thesar) si dhe pagesat drejtpërdrejt tek ofruesi i asistencës teknike për shpenzimet e shkaktuara. MMPH është përgjegjëse për mbajtjen e kontabilitetit si dhe për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të raportit financiar vjetor.

Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtij raporti financiar

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare..



---

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

MMPH kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e marrëveshjes së veçantë ndërmjet Qeverisë së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Suedisë, SIDA (Suedia);
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, (me plotësim ndryshimet); dhe
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013 për shpenzimin e parave publike.

Në kontekst të raportimit, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Raportimi financiar është bërë në përputhje me marrëveshjen, po ashtu janë përgatitur raporte narrative që përmbajnë një analizë mbi progresin e aktiviteteve të projektit dhe rezultatet.

Në kontekst të raportimit, ne nuk kemi çështje për të ngritur.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, planifikimin, çështjet e prokurimit, procesin e pagesave dhe detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Sistemi financiar dhe kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi janë të mira. Sistemet dhe transaksionet financiare janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe në pajtim me kërkesat e marrëveshjes. Bazuar në marrëveshje, plani dhe raportimi bëhet sipas planit dhe kërkesave të projektit për raportim. Janë identifikuar disa mospërputhje në mes të dhënave nga SIMFK dhe raportit i përgatitur sipas projektit.

Disa mangësi dhe arsye sa i përket raportimit, realizimit të buxhetit janë paraqitur në vijim ndërsa mangësi të tjera pa ndikim material janë shpalosur në Letër Menaxhment.

### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne kemi shqyrtuar planifikimin në bazë të linjave buxhetore të SIDA-së dhe shpenzimet e tyre.

Buxheti sipas thesarit është 1,075,082€, prej tyre të bartura nga viti 2017 janë 498,755€, ndërsa janë transferuar 576,327€. Ndërsa sipas linjave buxhetore të SIDA-së, janë planifikuar 689,515€. Kjo rrjedh pasi zyrtarët nuk i kanë kushtuar rëndësi harmonizimit dhe përshtatjes së formës së raportimit për SIDA me formën e raportimit vendorë.

Plani i prokurimit për vitin 2018 është aprovuar nga Komiteti Drejtues fillimisht me 01.03.2018, pastaj është rishikuar me 12.04.2018 dhe 30.10.2018, për t'iu përshtatur linjave buxhetore. Ndryshimi i buxhetit ka ndodhur në mes linjave për shërbime dhe punë, mirëpo brenda buxhetit total të linjave.

Në tabelën më poshtë është paraqitur buxheti fillestar i aprovuar dhe realizimi për vitin 2018.

**Tabela 2. Shpenzimet sipas linjave buxhetore të SIDA-as (në €)**

Përshkrimi	Buxheti planifikuar <sup>3</sup>	2018 Realizimi	2017 Realizimi
<b>Llojet e shpenzimeve/totali<sup>4</sup></b>	<b>689,515</b>	<b>502,854</b>	<b>119,506</b>
Prokurimi i shërbimit	273,516	185,178	94,906
Furnizim me pajisje	97,428	25,068	24,560
Punë	318,571	292,607	-

Në raportin financiar të PMK-së janë prezantuar shpenzime për vitin 2018 në vlerë prej 502,854€ ndërsa sipas të dhënave të thesarit shpenzimet ishin 445,557€. Kemi një diferencë prej 57,297€ e cila ka ndodhur për shkak të bazës së raportimit të PMK-së në raport me të dhënat e thesarit<sup>5</sup>.

Realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm, gjatë vitit 2018 janë shpenzuar 73% të buxhetit fillestar apo 502,854€. Përderisa, krahasuar me vitin 2017, kemi përmirësim të realizimit të buxhetit.

Nga tabela vërehet se tri linjat buxhetore nuk janë realizuar sipas buxhetit dhe në vijim jepen shpjegimet:

- Linja buxhetore për ofrimin e shërbimeve, është realizuar 67%. Disa nën kategori janë tejkalluar kryesisht për shkak të nënvlerësimit të shpenzimeve të vizitave studimore në Suedi

<sup>3</sup> Plani i prokurimit gjatë vitit 2018 është rishikuar me 01.03.2018, 12.04.2018 dhe 30.10.2018, për të ju përshtatur linjave buxhetore.

<sup>4</sup> Shërbimet e asistencës teknike, zbatohen nga ofruesi i shërbimeve kornizë(OShK), d.mt.h FCG (fillimisht ORGUT), dhe janë të rregulluara me anë të një kontrate të nënshkruar në mes të OShK-së dhe Ambasadës së Suedisë (AS). Ndërsa, prokurimi i pajisjeve dhe punëve, menaxhohet drejtpërsëdrejti nga MMPH-ja i asistuar nga OShK, në përputhje me marrëveshjen specifike të nënshkruar mes MMPH-së dhe AS-së.

<sup>5</sup> Shpjegimet detaje për këtë gjetur janë paraqitur në Letermenaxhment.

dhe Rumani si dhe nënvlerësimin të shpenzimeve të buxhetuara të përkthimit, sidomos atyre të përkthimit të publikimeve. Ndërsa, pjesa më e madhe e aktiviteteve të shtyra (të përealizuara) i përkasin konferencave.

- Linja buxhetore për furnizim për punë është realizuar rreth 91% ndërsa, buxheti për pajisje është shpenzuar vetëm 25% pasi që nuk janë realizuar të gjitha aktivitetet në vitin 2018 dhe janë shtyrë për vitin 2019.

Çështjet e ndërlidhura me procesin e shpenzimeve, prokurimin dhe zbatimin e rekomandimeve i kemi paraqitur në Letër Menaxhment të përgatitur krahas raportit të auditimit.

---

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.